

Forumi Kulturor
BULETIN INFORMATIV
Dhjetor 2014

Konferenca vjetore “Si të mendojmë kulturalisht?”
Dhjetor 2014



Forumi Kulturor mbajti konferencën vjetore “Si të mendojmë kulturalisht?”. Diskutimet e konferencës u zhvilluan në dy panele në të cilat u diskutua për modelin kulturor në dy nivelet e qeverisjes në Kosovë si dhe nevojën për të rishikuar qasjen e shtetit ndaj kulturës.

Për më shumë, shih: <http://forumikulturor.net/?page=1,9,95>

Takimi i rregullt i Kuvendit të Anëtarëve të Forumit Kulturor
Dhjetor 2014



Anëtarët e Forumit Kulturor mbajtën Kuvendin vjetor, në të cilin takim u bë prezantimi i raporteve vjetore, u diskutua për planet e FK për dy vitet e ardhshme, u zgjodh anëtari i pestë i Kryesisë së FK, u diskutua për rrjetëzimin e skenës së pavarur kulturore në nivel lokal, politikën e pagesës së anëtarësisë dhe shërbimet për zhvillimin e kapaciteteve të anëtarëve.

Për më shumë, shih: <http://forumikulturor.net/?page=1,9,109>

**Konferenca “Action Boxing Club”
Dhjetor 2014**



Action Boxing Club ishte hapur për publikun nga 12 shtatori deri më 11 tetor 2014, bashkë me hapjen e një ndërtesë me identitet të shumëfishtë.

Konferenca e projektit, prezentimet dhe një diskutim me panelistët Gjejlane Hoxha, Elana Katz, Nikola Radić and Sali Shoshi, i cili u moderua nga Albert Heta, u morrën me temat e ndërlidhura me ekspozitën Action Boxing Club, vazhdimin e hulumtimit të artistes, temat bashkëkohore dhe historike që kanë qenë shkaktar të hulumtimit dhe punës, metodat të kujtimit të Luftës së Dytë Botërore dhe pasojat, roli i artit dhe diskursi historik, dhe kujtesën e historisë hebraike në Kosovë.

Për më shumë, shih: <http://forumikulturor.net/?page=1,6,106>

Thirrje për aplikim “Anibar”
Dhjetor 2014



Animatorë nga e gjithë bota, ftohen që të bëhen pjesë e garës që do të mbahet në edicionin e 6'të të Festivalit Anibar. Këtë vit Anibari do t'i ketë katër kategori të çmimeve: Best Environmental, Best music video, Best production and Best children.

Për më shumë, shih: <http://forumikulturor.net/?page=1,6,107>

Konferenca vjetore e projektit “Qyteti gjithëpërfshirës – planifikim me pjesëmarrje për zhvillim të qëndrueshëm urban në Prizren”

Dhjetor 2014



EC Ma Ndryshe mbajti konferencën vjetore të projektit “Qyteti Gjithëpërfshirës – planifikim me pjesëmarrje për zhvillim të qëndrueshëm urban në Prizren”. Gjatë konferencës u prezentuan raportet e veçanta për secilin grup të komunitetit si dhe analizën e tretë që del nga hulumtimi me qytetarët e Prizrenit mbi planifikimin urban.

Për më shumë, shih: <http://forumikulturor.net/?page=1,6,108>